



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG  
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

**Nr. i doku. 21.16.1-2008-08**

**RAPORTI FINAL I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE TË  
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR  
MË 31 DHJETOR 2008**

**Prishtinë, 27 Korrik 2009**

## **Tabela e përmbajtjes**

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Gjendja e rekomandimeve nga vitet e kaluara
- IV. Fushëveprimi i auditimit
- V. Qasja e auditimit
- VI. Opinioni i auditimit
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

### **Shtojcat:**

- I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II. Komentet e MPB-së dhe Përgjigja e ZAP-it ndaj Komenteve

## Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
DAQ	Departamenti i Administratës Qendrore
DASHC	Dosja e Aplikacionit të Shërbyesve Civil
DPD	Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ILA	Institucionet e Larta të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
LMFPP	Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji Nr. 02/L-99 për Prokurimin Publik në Kosovë me ndryshimet dhe plotësimet e datës 8 shkurt 2007
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operator Ekonomik
QRA	Qendra e Regjistrimit të Automjeteve
QKRC	Qendra Komunale e Regjistrimit Civil
QOER	Qendra Operative Emergjente Regjionale
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UA	Udhëzimi administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

## I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008.

Auditimi ynë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara, nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne i vlerësuam si të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Për mendimin tonë, *pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale.

Si theksim i çështjeve dëshirojmë t'iu përkujtojmë faktin se:  
Pasuritë fikse nuk janë shpalosur në pasqyra financiare.  
(ISSAI 400 Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes ).

Auditimi ynë ka shpalosur disa dobësi që kanë të bëjnë me ekzekutimin e buxhetit dhe sistemin e kontrollit të brendshëm.

1. Mangësitë, në veçanti në kuadër të lëmisë së prokurimit, janë të natyrës serioze dhe duhet të adresohen urgjentisht. Procedurat e prokurimit lidhur me shpenzimet e përcaktuara me LPP dhe rregullat tjera në fuqi nuk zbatohen në tërësi.
2. Ka mungesë të kontrollit dhe verifikimit të faturave me dokumentet mbështetëse tek investimet kapitale, krahasimit në mes paramasës dhe situacioneve për punët e përfunduara, çka tregon për një mungesë të theksuar të kontrolleve, me mundësi të keqpërdorimit të parasë publike.
3. Nuk është bërë regjistrimi i plotë dhe i saktë i gjithë pasurisë që disponon MPB-ja në pasqyrat financiare,
4. Dështimi në mbylljen e avanseve për udhëtime zyrtare në periudha të gjata, tregon për mungesë të kontrollit të brendshëm, me mundësi të keqpërdorimit të parasë publike.
5. Vërtetimi ( certifikimi ) i pagesave me kode joadekuat ekonomike flet për një proces joadekuat të autorizimit dhe për një kontrollë të dobët të brendshme.
6. Auditimi i brendshëm duhet të fokusohet në fushat materiale me rreziqe më të mëdha për keqmenaxhim dhe joefektivitet.

Ne rekomandojmë Ministrin e Punëve të Brendshme që të merret me mangësitë e cekura më lartë me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të kontrollit financiar dhe menaxhmentit të ministrisë në fjalë.

## II. Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm sipas ligjit është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative që mirren nga institucioni ose subjekti që i është nënshtruar auditimit; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin;

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2008/13, dhe ato ti prezantoj me kohë.

## III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Raporti ynë i auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2007 kishte dhënë 7 rekomandime kryesore.

Auditimi i këtij viti ka vërejtur që MPB –ja ka zbatuar një rekomandim që kishte të bënte me të hyrat. Një rekomandim është implementuar pjesërisht, formimi i njësisë së auditimit të brendshëm ( NJAB) ndërsa rekomandimet tjera nuk janë zbatuar .

Me të rëndësishmet i paraqesim më poshtë:

- (a) Rekomandimi për zhvillimin e procedurave të prokurimit duke implementuar LPP.
- (b) Nuk është bërë regjistrimi i plotë dhe i saktë i gjithë pasurisë që disponon MPB.
- (c) Mbylljen e avanseve (paradhëniet për shpenzime të udhëtimit ) pas afatit të kërkuar.

Mos implementimi i plotë i rekomandimeve tona paraqet sinjal të fortë se mangësitë e raportuara më herët. Është për t’u shqetësuar mungesa e masave të vendosura nga menaxhmenti i lartë mbi të gjeturat dhe rekomandimet tona të auditimit.

## **IV. Fushëveprimi i auditimit**

Auditimi i MPB-së ka të bëjë me pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008.

Objektivi primar i këtij auditimi ishte që t'i mundësohet ZAP të shpreh opinionin e saj nëse pasqyrat financiare të MPB-së, japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë dhe nëse regjistrat financiarë, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me Ligjet dhe rregulloret aplikative.

## **V. Qasja e auditimit**

Auditimi ynë është realizuar gjatë periudhës 25 Mars 2009 deri më 25 Maj 2009, në bazë të Standardeve të Auditimit të INTOSAI-it.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona, ne:

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të MPB –së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2008
2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të MPB-së janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”.
3. Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, 5% për paqartësitë dhe 3% për gabimet, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
7. Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm në MPB për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë;

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin, informatat dhe shpjegimet të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të MPB-së, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit i cili mund të jepet. Opinionin e auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit (C f. Aneksi 1 ISSAI 400).

## VI. Opinioni i auditimit

Për mendimin tonë, *pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale.

Si theksim i çështjeve dëshirojmë t'iu përkujtojmë faktin se:

Pasuritë fikse nuk janë shpalosur në pasqyra financiare.

*(ISSAI 400 Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes).*

## VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

### 1. Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar( PF )

Analizën e rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar për kategoritë e shpenzimeve i kemi paraqitur në tabelën e mëposhteme.

**Tabela 1: Buxheti**

Nr.	Pagesat nga buxheti	Buxheti i aprovuar në €	Buxheti i shpenzuar në €	në %
1.	Pagat dhe Mëditje	3,075,640	2,977,916	97
2.	Mallrat dhe shërbimet	5,524,154	3,021,741	55
3.	Shpenzimet komunale	191,400	143,117	75
4.	Subvencionet	27,000	27,000	100
5.	Investimet Kapitale	6,401,291	4,931,520	77
6.	Gjithsej:	15,219,485	11,101,294	73

Për vitin 2008 obligimet e papaguara të MPB-së janë 156,842 €.

Gjatë analizave të rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt buxhetit të aprovuar mundë të vërehet se shpenzimet e paguara për v. 2008 kanë qenë në vlerë prej 11,101,294 € (shikoje tabelën e paraqitur më lartë).

Krahasuar me buxhetin e aprovuar MPB-ja, ka shpenzuar 73 % të buxhetit. Në fund të vitit 2008 ka pasë një buxhet të pashpenzuar 4,118,191 €. Pra, kemi një suficit buxhetor që ka rezultuar nga planifikimi jo i mirë apo joefikas në shfrytëzimin e procedurave mbi shpenzimet buxhetore.

### Konkluzioni

Buxheti MPB-së nuk është shpenzuar duke u bazuar në projeksionet fillestare. Menaxherët e departamenteve përkatëse nuk ishin të angazhuar për realizimin e objektivave siç ishte paraparë me planifikimet buxhetore.

Sipas vlerësimit tonë Ministria kishte shpenzuar buxhetin për vitin 2008 në kuadër të limiteve të përcaktuara, por në një shkallë më të ultë. Kjo shihet sidomos në kategorinë e shpenzimeve për mallra dhe shërbime (vetëm 55%), që do të thotë nuk kishte një planifikim real të buxhetit dhe për pasojë kishte bllokimin e mjeteve që kanë mbetur të pa shfrytëzuara.

## Rekomandim 1

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së që të siguroj :

- Që me rastin e përcaktimit të nevojave buxhetore dhe planifikimit të buxhetit, fillimisht të bëhen analiza të detajuara. Aspektet e planifikimit duhet të përmirësohen dukshëm.
- Alokimet buxhetore duhet të bëhen në pajtim me kërkesat sipas departamenteve. Pjesëmarrës aktiv në përpilimin e buxhetit duhet të jetë menaxhmenti i lartë i MPB-së, sepse ata janë përcaktues direkt të objektivave vjetore. Një monitorim i shtuar mbi shkallën e realizimit të buxhetit është më se i nevojshëm.

## 2. Pasqyrat financiare

- Pasqyrat financiare të vitit 2008 janë të sakta dhe të prezantuara drejt në aspektin material dhe në pajtim me UA 2008/13 të MEF-it “Raportimi vjetor i organizatave buxhetore”.
- Të gjitha pasuritë jofinanciare nuk janë paraqitur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

## Rekomandimi 2

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së që të siguroj :

Që pasqyrat financiare duhet të tregojnë shpalosjen e pasurive.

## 3. Ekzekutimi i Buxhetit

### Të Hyrat

Të hyrat vetanake në MPB për vitin 2008 janë 25,887,410 €. Të hyrat në MPB arkëtohen nga pesë lloje taksash të cilat i paraqesim në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 2: Llojet e të hyrave në MPB**

Nr.	Të Hyrat	2008	2007
1.	Taksat nga regjistrimi i automjeteve	6,669,989 €	5,858,532€
2.	Taksat nga lejet e vozitjes	1,077,792 €	765,288€
3.	Taksat nga dokumentet e udhëtimit	8,277,217 €	
4.	Taksa rrugore	9,194,363 €	8,318,801€
5.	Taksat nga vulat verifikuese	668,049 €	687,540€
	<b>Gjithsej:</b>	<b>25,887,410 €</b>	<b>15,630,161€</b>

Ministria e Punëve të Brendshme ( MPB ) për vitin 2008 ka realizuar të hyra në vlerë prej 25,887,410 €, ndërsaq në vitin 2007 të hyrat ishin 21,350,738 €. Kjo do të thotë se në vitin 2008 ka rritje prej 4,536,672 € apo 21,25 % më shumë se një vit më parë.



Kjo rritje është rezultat i implementimit të programit për paisje të qytetarëve me pasaporta të Republikës së Kosovës.

## **Konkluzioni**

Të hyrat vetanake janë regjistruar sipas kodeve të sakta ekonomike të përcaktuara nga Departamenti i Thesarit si dhe janë bërë barazimet mujore në mes të dhënave të departamenteve, regjistrave të bankës dhe librit kryesor të Departamentit të Thesarit.

## **Pagat dhe Mëditjet**

Sipas pasqyrave financiare, buxheti i aprovuar për paga dhe mëditje kap shumën prej 3,075,640 €. Shpenzimet aktuale për paga gjatë vitit 2008 ishin 2,977,916 €, krahasuar me vitin 2007 është shënuar një rritje për 1,289,399€ apo 76% .Kjo rritje ishte si rezultat i zgjatjes së orarit të punës së personelit për pajisje të qytetarëve me pasaportat e Republikës së Kosovës. MPB ka hartuar planin për shtimin e punës jashtë orarit në disa departamente (11 orë pune në ditë dhe 8 orë pune të shtunave) me Vendim të institucioneve ekzekutive të MPB-së gjegjësisht, sipas Vendimit të Kryeministrit nr. 10/25 datë 03.07.2008).

Ne kryesisht kemi testuar mirëmbajtjen e dosjeve të personelit, përputhjen e pagës në kontratë me sistemin e Pay-roll-it si dhe mënyrën e rekrutimit të stafit.

Nga lista e personelit kemi përzgjedhur për testim 18 dosje të personelit dhe rishikimi ynë ka rezultuar me këto të gjetura:

- Në tri raste punësimi, janë lidhur kontrata pune pa procedurë rekrutuese dhe pa ndonjë vendim përkatës nga menaxhmenti, çka është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP/DASHC 2003/01 “Procedurat e rekrutimit” për zbatimin e UA 2003/2 zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës.
- Për tre punëtorë janë lidhur kontratat e punës më herët, pastaj është bërë shpallja e konkursit për rekrutim. Edhe pse të njëjtit nuk i kanë plotësuar kriteret, ata kanë qenë të favorizuar nga komisioni vlerësues dhe janë pranuar si të rregullt në pozitat përkatëse, po ashtu në dosje nuk ka pasur dëshmi për përvojat e mëparshme.
- Në një rast komisioni intervistues në raportin ( 17.06.2008) dërguar Sekretarit të Përhershëm të MPB-së ka kërkuar që të anulohet konkursi pasi që të gjithë kandidatët janë vlerësuar me më pak se 50% të pikëve, por përkundër kësaj sekretari ka zgjedhur aplikantin me 47% të pikëve në pozitën përkatëse përkohësisht (kontratë tre mujore) e pas kësaj periudhe i është ofruar kontratë tre vjeçare.

## **Konkluzioni**

Nuk janë aplikuar në tërësi dispozitat e udhëzimit administrativ për rekrutimin e kandidatëve të rinj në bazë të kriterëve dhe procedurave të parapara. Kjo gjendje ka shkaktuar rekrutime të paligjshme, mundësi reale për konflikt të interesave tek personeli menaxhues dhe njëkohësisht ka rritur rrezikun për shpërdorim të detyrës zyrtare.

### **Rekomandimi 3**

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së që të siguroj që:

- Rekrutimet janë bërë në pajtueshmëri të plotë me nenin 2,3 dhe nenin 5 pika d të Udhëzimit Administrativ nr.MSHP/DASHC 2003/1 Procedurat e Rekrutimit, për zbatimin e Urdhërësës Administrative nr. 2003/2 zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës.

### **Shpenzimet përmes procedurave të prokurimit**

Gjatë vitit 2008 Ministria e Punëve të Brendshme ( MPB ) ka bërë prokurime që kapin shumën totale prej 4,684,030 €. Në bazë të gjykimit kemi përzgjedhur për rishikim një mostër prej 30 prokurimesh në vlerë prej 3,226,720€ ose 69% nga vlera totale e prokurimeve. Prej tyre, mallra dhe shërbime 19 mostra në vlerë prej 743,977 € dhe investime kapitale 11 n mostra në vlerë prej 2,482,745 €.

Të gjeturat e identifikuar në procesin e prokurimit janë si në vijim:

### **Mallrat dhe Shërbimet**

1. Në katër prokurime që arrin vlerën prej 36,669 € MPB-ja ka bërë ndarjen e tenderëve për ti ikur procedurave të hapura edhe pse neni 15.4 të LPP nr.02/L-99 e specifikon se asnjë autoritet kontraktues, nuk do të ndajë kërkesën për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 18.

- furnizim me material higjenik dy kontrata ( 8,672 € & 9,281 € ) të nënshkruara më 06.03.2008 dhe 03.07. 2008 dhe
- furnizim me bateri për UPS dy kontrata ( 9,936€ & 8,780€ ) datë 23.04.2008 dhe 21.07.2008.

2. Në tri kontrata në vlerë prej 617,909 € , pagesat janë kryer prej kodeve ekonomike joadekuate; Furnizim me patentë shofer ( 13610-furnizim për zyre), Furnizim me rafta të metalit dhe dollapë si dhe Furnizim me mobilie-orendi (31900-kapital tjetër).

3. Në kontratën Furnizim me material higjenik në vlerë 9,281€ e nënshkruar më 03.07.2008, sigurimi i ekzekutimit është lëshuar 14 ditë pas nënshkrimit të kontratës (17.07.2008) në vlerë prej 600€, vlerë e cila nuk korrespondon me 10% të vlerës së kontratës si dhe në kundërshtim me nenin III. 2) të dosjes së tenderit.

4. Në kontratën furnizim me Paisje të TI-së për DPD-në, në vlerë prej 51,348 € nuk është aplikuar “Deklarata e nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve” siç kërkohet në nenin 8.5 të LPP.

5. Në kontratën Furnizim me material higjenik të nënshkruar me 06.03.2008 një pjesë e mallrave nga OE janë dërguar 12 ditë para nënshkrimit të kontratës, gjegjësisht më 22.02.2008 sipas fletdërgesës nr.01/08.

6. Në prokurimin me nr.214/207/08/073/236 në regjistrin e tenderëve të dorëzuar janë të evidentuar katër (4) kompani ( ofertues ), kurse në procesverbalin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave janë evidentuar pesë (5) kompani.

7. Në nëntë kontrata që gjithsej arrijnë shumën 110,215 € Urdhërblertjët janë përgatitur dhe i janë dërguar Operatoreve Ekonomik pasi janë pranuar faturat, edhe pse Rregulla dhe Udhëzimet e Thesarit- 02 Shpenzimi i Parave Publike përcakton se Urdhërblertja krijohet dhe përgatitet nga ana e organizatës buxhetore, pas procesit të selektimit të tenderëve, për të hyrë në marrëdhënie juridike me furnizuesin e suksesshëm.

## **Konkluzion**

Menaxhmenti i MPB ka dështuar në implementimin e kërkesave të Ligjit të Prokurimit Publik. Kontrolli i brendshëm ishte i dobët lidhur me monitorimin e shpenzimeve të parasë publike. Mungesat e kontroleve të nevojshme ndikojnë në rritjen e rreziqeve për shpërdorimin, keqpërdorimin dhe humbjen e mjeteve publike.

## **Rekomandim 4**

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së që të siguroj se:

Procesi i prokurimit është përforcuar dhe kontrolli i brendshëm i MPB-së është kryer në mënyrë efektive.

## **Investimet Kapitale**

1. Në dy kontrata në vlerë të përgjithshme prej 480,725 € ( 226,865 € & 253,859 € ) ka pasur mbivlerësim të faturave si rezultat i mospërputhjeve të Paramasës dhe Situacioneve:

- Në kontratën nr. 214/08/050/521, Situacioni i I-rë, paragrafi 3.4 rritje e çmimit për njësi nga 65 € në 165 €, pra kemi një rritje të shumës totale nga 2,925 € në 7,425 €. Mbivlerësimi është në vlerë prej 4,500 €. Më tutje, paragrafi 3.17 rritje e çmimit në total prej 23,750 € në 25,061 €. Gjithashtu edhe në këtë rast kemi një mbivlerësim në vlerë prej 1,311 € dhe
- Situacioni i II-të, paragrafi II,4 (rrjeti i gypave) rritje e çmimit nga 750 € në 6,547 €, që ka ndikuar në rritjen e shumës totale nga 375 € në 73,273€. Mbivlerësimi është në vlerë prej 2,898 € dhe
- Në kontratën me nr. 214/08/042/521, në Situacionin e II-të paragrafi 15.9 ka ngritje të shumës prej 3,500 € në 3,800 €. Pra, vërehet një mbi pagesë në vlerë prej 300 €. Për të gjitha rastet e lartë shënuara kemi një mbipagesë në vlerë prej 9,009 €.

2. Në tri kontrata në vlerë të përgjithshme prej 324,193 € punimet nuk kanë përfunduar sipas planit dinamik ( kushteve të kontratës ).

- Kontrata Punimi i rrethojës, shkallëve dhe murit mbrojtës në QRA-Pejë (lot 3) dhe Renovimi i objektit të QOER në Pejë (lot 5) nënshkruar më 05.11.2008 ( plani dinamik 28 ditë pune) deri në përfundim të vitit objektet nuk kanë përfunduar.
- Në kontratën Renovim i objektit të SHPK-së për QRA-QKRC në Skënderaj të nënshkruar më 22.08.2008 (planin dinamik 35 ditë pune), punimet kanë filluar më

datën 29.08.2008 dhe kanë përfunduar më 16.12.2008) siç shihet me një vonesë prej tetë-(8) javësh.

- Ndërtimi i objektit të QKRC dhe QRA në Shtime, nënshkruar më 28.07.2008 ka pasë vonesa prej pesë(5) javësh (duhet të përfundonte më 07.10.2008, kurse kanë përfunduar më 16.12.2008). Më datën 28.04.2009 ekipi i ZAP-it ka bërë ekzaminim në objekt ku ka vërejtur se punët nuk kanë përfunduar në tërësi sipas kushteve të kontratës, si: vendosja e rezervuarit të naftës prej 3000 litra, si dhe mbjellja e barit kualitativ, drurëve halorë. Kemi vërejtur punime jo kualitative si plasaritje të suvatimit të jashtëm, pllakat e mureve të ç'vendosura..

3. Në shtatë kontrata në vlerë të përgjithshme prej 640,622 € sigurimi i ekzekutimit (10%) të vlerës së kontratës ka vlefshmëri një (1) vjeçare, pra nuk e mbulon periudhën e garantuar nga Operatori Ekonomik(OE), gjegjësisht deri në afatin 12 muaj pas pranimit të punës nga komisioni profesional siç kërkohet në nenin 11.1 të kontratës.

4. Në kontratën për furnizim me dokumente udhëtimi (Pasaporta) në vlerë prej 1,825,426 € pagesat janë kryer nga kodi ekonomik 31900-kapital tjetër. MPB-ja nuk ka bërë shpalosje në pasqyra financiare.

5. Në lëndën me nr. 214/208/08/094/136, Ngjyrosja e mureve dhe polishimi i dyshemesë në DPD, në vlerë prej 8,835 €. MPB ka shpërblyer OE i cili ka qenë i papërgjegjshëm sepse dëshmia nga ATK-ja e paraqitur nga OE është kopje, kurse në dosjen e tenderit kërkohet dokument origjinal ose kopje e vërtetuar.

6. Në planin përfundimtar të prokurimit nuk janë të specifikuara projektet që do të realizohen në vlerë dhe sasi, por janë të paraqitur në vlerë të përgjithshme.

## **Konkluzion**

Gjetjet e identifikuar më lart janë rezultat i kontrolleve të dobëta nga menaxhmenti i MPB-së.

Prokurimet e sipër përmendura të MPB-së, kanë shkelur rregulloret e prokurimit. Mangësitë e vërejtura në lidhje me kontrollet e brendshme të MPB-së për sa i takon prokurimeve, janë jashtëzakonisht serioze dhe në mënyrë të theksuar e rrisin rrezikun e prokurimeve të MPB-së ndaj mashtrimit, humbjes dhe keqpërdorimit. Puna jonë audituese ka vërtetuar shkelje të mundshme të ligjeve në Kosovë në këto raste.

## **Rekomandim 5**

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së që :

MPB-ja duhet të ndërmerr hapa në përmirësimin e trajtimit të investimeve kapitale dhe kontrollit. Gjatë kohës së këtij përmirësimi, të merren parasysh çështjet në vijim:

- Respektoj në tërësi kushtet e kontratës të lidhur në mes të MPB-së dhe OE si dhe realizimin sipas specifikacionit teknik të paraparë me dosje të tenderit. Për faturat e mbivlerësuara duhet të kërkohet nga OE që këto mjete të kthehen në buxhetin e

MPB-së Personat përgjegjës të MPB-së duhet të jenë palë aktive në zgjidhjen e kësaj çështje.

- Aplikoj penalet për mos kryerjen e punimeve në kohën e paraparë sipas kushteve të kontratës.
- Që të respektohen kushtet e kontratës bazë .
- Pagesat të bëhen në bazë të kodeve ekonomike adekuate.
- Siguroj që të gjitha vendimet mbi dhënien e kontratës, të jenë të dokumentuara për sa i përket bazës për përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues dhe nëse ofertuesi më i lirë nuk është përzgjedhur, duhet të jepet arsyeja përse;
- Përgatitjen e planit përfundimtar të prokurimit më të detajuar në mënyrë që investimet kapitale të bëhen në bazë të planit dhe në kohë.

### **Avanset për shpenzime të udhëtimit**

Për udhëtime të jashtme zyrtare MPB-ja ka shpenzuar €88,006. Kemi zgjedhur (9) mostra në shumë prej € 26,379 nga ajo totale. Kemi vërejtur disa veprime janë në kundërshtim me udhëzimin administrativ 2004/07 të MSHP për udhëtime zyrtare dhe tarifave të përcaktuara nga MEF-i.

1. Në dy udhëtime zyrtare (avansi në vlerë 2,448 € dhe avansi prej 5,000 € ) shpenzimet e udhëtimit janë paguar më tepër ( 532€ ) se sa janë të lejuara me udhëzimin administrativ.
2. Dy avanse në vlerë prej 2,448 € dhe 1,867 € janë mbyllur me vonesë prej 26 gjegjësisht 11 ditësh. Kjo është në kundërshtim me rregullat financiare dhe udhëzimet e thesarit 02 shpenzimi i parave publike, ku në pikën 9.1 ceket se të gjitha avanset duhet të mbyllen brenda dy javësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

### **Konkluzioni**

MPB-ja nuk ka kontroll të mjaftueshme mbi dhënien e avanseve, mënyrën e kthimit dhe arsyetimin e tyre.

### **Rekomandim 6**

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së të siguroj që:

6.1 Të rishikoj proceset e trajtimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe përmirësimin e kontrolleve të brendshme. Pikënisja e kësaj do të gjendet në udhëzimin administrativ nr: 2004/07

## **Paraja e imët**

Gjatë auditimit kemi identifikuar rastet të cilat kanë qenë në kundërshtim me LMFPF dhe Rregullës Financiare -02 si: pagesa për ushqim dhe pije, furnizim për zyrë, pagesa për sigurim shëndetësor, blerja e telefonave, furnizim me orë dore. Gjetjet në vijim flasin për veprimet që janë në kundërshtim me rregulloret në fuqi:

- Vlera prej 24 € është paguar për sigurim shëndetësor (fat nr. 066648 dhe 06664 datë 16.12.2008)
- Më datën 07.07.2008 në vlerë prej 100€ janë paguar obligimet e vitit 2007 (fat. nr. 111/p data 05.12.2007 )
- Vlera prej 155 € e shpenzuar për pije dhe ushqim është paguar me dy fatura dhe nga kodi i Departamentit të Administratës Qendrore shërbimi është shfrytëzuar nga kabineti i ministrit.

## **Konkluzion**

Kontrollet e brendshme lidhur me paratë e gatshme janë të mangëta.

MPB-ja nuk është mbështetur në rregulloret e Thesarit që ka të bëjë me limitet e shumës maksimale të parasë së gatshme nga të cilat janë bërë këto pagesa. MPB-ja duhet të insistoj në përforcimin e një sistemi më të mirë të kontrollit të brendshëm lidhur për të siguruar se aktivitetet e saja me paratë e tilla të koincidojnë me rregulloren e Thesarit.

## **Rekomandim 7**

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së që të :

Vendosë politika dhe procedura të shkruara që rregullojnë përdorimin e fondit të parasë së gatshme, të cilat do të specifikonin çështjet si: për çfarë mund të përdoret paraja e gatshme, limitet në transaksionet e caktuara me para të gatshme dhe dokumentacioni i nevojitur për të proceduar me pagesën nga fondi i parasë së gatshme;

MPB po ashtu duhet të sigurojë pajtueshmëri të plotë me kërkesat e Rregullës Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit 02- Shpenzimet e parasë publike.

## **Menaxhimi i pasurive**

Puna jonë audituese ka shpalosur këto gjetje:

- Nuk është përfshirë e gjithë pasuria kapitale dhe jo kapitale mbi 1,000 € në regjistrin kontabël, nuk është shpalosur pasuria jo financiare e disa departamenteve: Departamenti i administratës qendrore (DAQ), Departamenti i regjistrimit të gjendjes civile (DRGJC), Departamenti i menaxhimit të emergjencave (DME), Inspektorati Policorë i Kosovës (IPK).
- Moskryerja e procesit të inventarizimit në mënyrë të plotë në pajtim me UA 2005/11- Menaxhimi dhe regjistrimi i pasurive qeveritare( ne kemi inspektuar departamentet në objektin e “Kosovares”).

- Nuk është plotësuar formulari i raportit të mos përputhjeve nga ana e komisionit, ku paraqiten mos përputhjet në mes të regjistrit kontabël dhe gjendjes faktike.
- Inventari dhe pajisjet nuk janë të pajisura me Bar-kode)

## **Konkluzion**

MPB nuk kishte plotësuar kërkesat përkatëse në lidhje me pasurinë e saj. Nuk janë kryer inventarizimet vjetore të fund-vitit dhe MPB nuk ka siguruar që regjistrat kontabël të saj të jenë të saktë dhe të kompletuar. Regjistrat e pasurisë së MPB-së që tregojnë pasurinë e vlerësuar, nuk janë të besueshëm. Si rezultat, MPB nuk ka kontroll mbi pasurinë e saj, gjë që rrit rrezikun e vjedhjes dhe shpërdorimit të saj. Për të siguruar mbrojtjen e duhur për pasurinë e saj, MPB duhet që menjëherë të themelojë një sistem të kontrollit të brendshëm dhe të sigurojë që i njëjti t'i përmbahet rregulloreve që kërkojnë kryerjen e inventarizimit të pasurisë në fund të vitit, regjistrimin dhe sistemimin adekuat të tyre.

## **Rekomandim 8**

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së që të sigurojë :

- Krijimin e një sistemi të përbashkët për regjistrimin e pasurive, i cili mund të ndërlidhet me modulën e kontabilitetit, kjo do të sigurojë që të gjitha pasuritë e blera dhe të gjitha lëvizjet janë regjistruar plotësisht dhe saktësisht në regjistrin e pasurive fikse.
- Të kryej inventarizimin e plotë të pasurive periodikisht ( çdo vit ) dhe rezultatet e inventarizimit të harmonizoj me regjistrin e pasurive dhe atë të kontabilitetit.
- Për artikujt që mungojnë si rezultat i harmonizimit në mes të regjistrit dhe ekzistencës fizike të listës së aseteve, duhet të hetohen dhe nëse është e nevojshme të çregjistrohen.
- Që të gjitha asetet dhe inventari duhet të jenë të identifikuar me një numër (Barcode) të asetit i cili interferon me regjistrin e aseteve fikse.

## **4. Sistemi i Kontrollit të brendshëm dhe auditimi i brendshëm**

Kontrolli i brendshëm është aktivitet i pavarur i sigurisë së objektivave i dizajnuar vlerat dhe përmirësuar veprimet e organizatës. Ndihmon në kryerjen e obligimeve të saj duke sjellur një qasje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe proceseve qeverisëse. Auditimi i brendshëm është përgjegjës për të verifikuar se menaxhimi dhe sistemi kontrollues i përmbahen specifikacioneve të buxhetit, objektivave, rregullave dhe standardeve dhe parimeve të menaxhimit të qëndrueshëm financiar.

Në bazë gjetjeve të auditimit konkludojmë se sistemi i kontrollit të brendshëm përcillet nga dobësi të shumta, për të cilat ZAP, më lartë ka dhënë rekomandimet përkatëse, të cilat menaxhmenti i MPB besojmë se do t'i zbatojë me kujdes.

Në kuadër të kontrollit të brendshëm, ZAP ka vlerësuar edhe funksionin e auditimit të brendshëm. Ne kemi intervistuar auditorët e brendshëm dhe kemi rishikuar raportet e tyre.

Njësia e auditimit të brendshëm ka përgatitur 5 raporte për vitin 2008, dy prej tyre me kërkesë të menaxhmentit dhe ka paraqitur gjetjet dhe rekomandimet të cilat duhet të implementohen nga menaxhmenti.

Vlerësimet tona janë se NJAB nuk kishte bërë një auditim gjithëpërfshirës të Ministrisë për vitin 2008 ( të hyrat, pasuritë, zyrën për buxhet dhe financa).Gjatë vitit 2008 MPB nuk e ka themeluar komitetin e auditimit të brendshëm, siç parashihet me nenin 5 te Ligjit mbi Auditimin e brendshëm, mirëpo gjatë periudhës së auditimit ne kemi konstatuar se është formuar komiteti i auditimit.

## **Konkluzion**

Kontrollet e brendshme janë të dobëta për të ofruar një siguri të arsyeshme se sistemet e dizajnuara dhe politikat e vendosura nga ana e menaxhmentit janë duke funksionuar në mënyrën e duhur dhe i përmbushin objektivat që kanë për qëllim t'i ndihmojnë menaxhmentit në parandalimin ose zbulimin e gabimeve materiale, humbjeve ose mashtrimeve të mundshme.

Krahas dobësive të identifikuara në kontrollet e përgjithshme të MPB-së, kemi vërejtur se edhe auditimi i brendshëm nuk përmbush mjaftueshëm funksionin e tij. Një rol më aktiv i auditorit të brendshëm dukshëm do të ndikoj në përmirësimin e kontrolleve të brendshme të MPB-së.

## **Rekomandim 9**

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së të siguroj :

Që njësia e auditimit të brendshëm t'i planifikoj aktivitetet e saja të auditimit duke u përqendruar në ato fusha me rrezik të lartë dhe të cilat kanë ndikim potencial në paraqitjen e pasqyrave financiare.

Që auditorit të brendshëm t'i sigurohet një pavarësi e veprimit dhe raportet e përgatitura të auditimit të analizohen dhe implementohen.



## Shtojca 1

### Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009 (e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; i
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionit. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) ka patur limitime në fushëveprimin e auditimit
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë

prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

**15. Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

## Shtojca II: Komentet e MPB-së dhe Përgjigja e ZAP-it ndaj Komenteve

<b>Komentet e Ministrisë</b>	<b>Përgjigja e ZAP</b>
<b>Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar.</b>	
<b>Komenti nr. 1</b> Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime mos realizimi i buxhetit në masë të duhur ka ndodhur si pasojë e mos implementimit të projektit për ndërrimin e targave të automjeteve pasi që fjalën përfundimtare për këtë projekt është' dashtë ta japin ndërkombëtarët, pra ata nuk kanë lejuar kodin e veçantë për (shkronjat) që do të vendoseshin në targat e automjeteve. Ndërsa një pjesë e mjeteve ka qenë për furnizim me patentë shofer e cila ka filluar të implementohet qysh në vitin 2008 dhe është në vazhdimësi edhe në këtë vit.	<b>Rekomandimi nr. 1</b>  Pasi që në Planin Përfundimtar të Prokurimit të MPB-së ( nr.83/08 date 27.03.2008), nuk është paraparë shpenzimi për furnizim me Targa për automjete, si dhe vlera e mjeteve të ndara për furnizim me Patentë shofer në total është 450,000 € dmth nuk mund të arsyetohet suficiti buxhetor i MPB-së. Mbetet e gjetura dhe konkluzioni i ZAP-it në raport.
<b>Pagat dhe mëditjet</b>	
<b>Komenti nr. 3</b> Do të bëhen përpjekje maksimale që në bashkëpunim me Departamentet e MPB-së, nevojat për punësim të planifikohen në kohë të duhur dhe që vendet e punës të plotësohen në harmoni me rregulloret gjegjëse administrative	<b>Rekomandimi nr. 3</b> MPB e pranon të gjeturën dhe konkluzionin e ZAP-it.
<b>Prokurimi</b>	
<b>Mallra dhe shërbime</b>	
<b>Komenti nr. 4.1</b> Në rastin e 4 furnizimeve në vlerë prej 36,669€ të cekura, Autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ndarjen e kërkesës me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 18, sepse këtu nuk ka të bëjë me një kërkesë të menjëhershme e cila është ndarë por kërkesat për furnizim me UPS janë nga njësi të ndryshme të kërkesës, nga Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve dhe tjetra nga Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave dhe kërkesat janë bërë njëra prej tjetrës me një diferencë kohore prej rreth 4 muajsh (kjo shihet edhe nga datat e nënshkrimit të	<b>Rekomandimi nr. 4.1</b> Mbetet e gjetura dhe konkluzioni i ZAP-it.  Furnizimet janë paraparë në planin përfundimtar të prokurimit, prandaj një ndarje e tillë është bërë me qëllim të shmangies së procedurave të prokurimit. Rekomandimi i ZAP-it mbetet pjesë e raportit.

kontratave, e para më 06.03.2008 dhe e dyta më 03.07.2008), kjo ka ndodhur në të njëjtën mënyrë edhe me rastin e furnizimit me material higjenik.	
<p><b>Komenti nr. 4.2</b></p> <p>Në tri kontrata me vlerë prej 617,909 € (për furnizim me patentë shofer nuk kemi pasur mundësi të përdorim ndonjë kod tjetër ekonomik pasi që ky llogaritet të jetë furnizim ato janë librezat bllanko dhe mund të themi se është furnizim i zyrës. Por ne nuk pajtohemi me ju në rastin kur ju keni paraqitur dy vërejte në njërin anë pse kemi realizuar furnizim me pasaporta prej investimeve kapitale në anën tjetër keni thënë pse është bërë furnizimi prej kodit furnizim i zyrës. Por në vitin 2010 të gjitha furnizimet me pasaporta, patente shofer dhe letër njoftime MPB-ja do ti bëjë nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime por për kodin e vegante për këtë furnizim ne na duhet të konsultohemi me MEF nëse ka mundësi të hapet një kod ekonomik vetëm për këtë furnizim sepse kjo është kompetencë ekskluzive e MEF-hapja kodeve të reja. Ndërsa për furnizim me dollapë dhe orendi është përdor ky kod pasi që projekti ka qenë i përbashkët ndërtimi, renovimi i objekteve dhe inventarizimi. Por në të ardhmen këto nuk do të përsëriten .</p>	<p><b>Rekomandimi nr. 4.2</b></p> <p>Mbetet e gjetura dhe konkluzioni i ZAP-it.</p> <p>Ne kemi theksuar se nëse janë të regjistruara në kodin e kategorisë së shpenzimeve kapitale, duhet të bëhet shpalosja e tyre.</p>
<p><b>Komenti nr. 4.3</b></p> <p>Me rastin e furnizimit me material higjenik me qëllim të sigurimit të realizimit të kontratës kemi kërkuar sigurimi i ekzekutimit 10% nga vlera e kontrates. Autoriteti kontraktues në këtë rast pasi është kontratë afatgjate nuk do ta plotëfuqizoj kontratën pa e dorëzuar garancionin operatori ekonomik të cilit i është dhënë një kontratë, që të depozitoj një siguri të ekzekutimit si parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontrates.</p>	<p><b>Rekomandimi nr. 4.3</b></p> <p>Mbesin konstatimet në Raport.</p> <p>Neni 60. te pika 60.2 të LPP-se theksohet: “autoriteti kontraktues do të kërkojë nga operatori ekonomik të cilit i është dhënë ndonjë kontratë me vlerë të mesme ose të madhe, që të depozitojë një siguri të ekzekutimit <b>si parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës së tillë.....”</b></p>
<p><b>Komenti nr. 4.4</b></p> <p>Te kontrata për furnizim me Pajisje të TI për DPD në vlerë prej 51,348 €, para fillimit të procedurës së prokurimit, pasi që kontrata ka qenë për një furnizim kemi bërë Kërkesën e</p>	<p><b>Rekomandimi nr. 4.4</b></p> <p>Mbetet e gjetura dhe konkluzioni i ZAP-it.</p> <p>Arsyetimi nuk qëndron, pasi që MPB-ja nuk ka</p>

<p>Zotimit për Blerje me të cilën Zyrtari Autorizues na nënshkruan dhe na vërteton se mjetet janë në disponim dhe ne mundemi me i filluar procedurat e prokurimit, kurse për kontratat afatgjate <i>Duke ju referuar Nenit 8 të Ligjit Nr. 2003/17, Ligji mbi Prokurimin Publik</i>, kemi përgatitur Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimi i Disponueshmërisë së Mjeteve dhe Kërkesën e Zotimit për Blerje e bëjmë para nënshkrimit të Kontratës.</p>	<p>pasur sukses të ofroj dëshminë e ekzistimit të një dokumenti të tillë.</p>
<p><b>Komenti nr. 4.5</b> Te kontrata furnizim me material higjenik të nënshkruar më 06.03.2008 mallrat janë pranuar pas nënshkrimit të kontratës, me këtë rast kemi të bëjmë me një datë në një fletë dërgesë e cila ka qenë një gabim teknik të cilin nuk e kanë vërejtur me rastin e pranimi të materialit higjenik.</p>	<p><b>Rekomandimi nr. 4.5</b>  MPB e pranon të gjeturën dhe konkluzionin e ZAP-it.</p>
<p><b>Komenti nr. 4.6</b> Në prokurimin me nr. 214207/08/073/236 në regjistrin e tenderëve të dorëzuar janë evidentuar 4 kompani(ofertues) kurse në procesverbalin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave janë hapur 5 oferta - kjo ka ndodhur për shkak se është harruar të plotësohet oferta e fundit në këtë regjistër të pranimi të ofertave- kjo në të ardhmen nuk do të përsëritet</p>	<p><b>Rekomandimi nr. 4.6</b>  MPB-ja e pranon të gjeturën dhe konkluzionin e ZAP.</p>
<p><b>Investime Kapitale</b></p>	
<p><b>Komenti nr. 5.1</b> Në dy kontrata në vlerë të përgjithshme prej 480,725 € (226,865€ dhe 253,859 €) janë bërë mbivlerësime. Në kontratën nr. 214/08/050/521 janë bërë gabime në llogaritje nga ana e punëmarrësit, të cilat organi mbikëqyrës i MPB-së është dashur mos i lejoj se është detyrë dhe obligim i tij. • Gjatë kryerjes së punimeve nga Menaxheri i projektit nga kompania mbikëqyrëse ka konstatuar se ka nevojë për punë shtesë të cilat nuk kanë mundur me u parapa me kohe, në vlerë prej 19,405.56 € ose 8,55 % nga vlera e punës së kontraktuar prej 226,865.48 €, për shkak të procedurave dhe kërkesës për miratim në Agjencionin e Prokurimit, është prolonguar dhe vonuar</p>	<p><b>Rekomandimi nr. 5.1</b>  MPB-ja është pajtuar me të gjeturën e paraqitur në raport edhe në shprehje që këto mjete të kthehen buxhetit të MPB-së, Ne kemi kënaqësinë të raportojmë fillimin e implementimit të rekomandimeve të cilat japin një dëshmi të fortë të gatishmërisë së menaxhmentit të MPB-së për të njohur dobësitë e raportuara dhe për të ndërmarr masa për implementimin e rekomandimeve. Personat përgjegjës të MPB-së duhet të jenë palë aktive në zgjidhjen e kësaj çështje.</p>

<p>realizimi i këtij projekti (është penalizuar për këtë vonesë) i cili tani ka përfunduar dhe është pranuar nga komisioni i pranimit teknik dhe në Situacionin e fundit të cilin ende nuk ia kemi paguar, të cilin jemi duke e pritur me e pranuar, do t'ia ndalim gjithsesi këto shuma të llogaritura dhe të mbivlerësuara më tepër(shih shkresën nr. 056 e datës 05.07.2009) drejtuar kompanisë "MABB". 3.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në kontratën nr. 214/08/042/521 janë bërë gabime në llogaritje nga ana e punëmarrësit, të cilat organi mbikëqyrës i MPB është dashtë mos ti lejoje se është detyrë dhe obligim i tij. Nga kompania punëmarrëse do të kërkojmë dhe do t'ia arrijmë të na kthejë në llogarinë tonë këtë shumë të mbivlerësuar më tepër prej 300 € (shih shkresën nr. 057 e datës 05.07.2009) drejtuar kompanisë "ALBES".</li> </ul>	
<p><b>Komenti nr. 5.2</b></p> <p>Në katër kontrata në vlerë* të përgjithshme prej 551,059 € punimet nuk kanë përfunduar sipas planit dinamik (kushteve të Kontratës)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në Kamenicë pasi që kompania punëmarrëse nuk i ka kryer obligimet në pajtueshmëri me kontratën me nr. 214/08/050/521 e nënshkruar në datën 12.08.2008 me këtë rast MPB, Zyra e Prokurimit, në pajtueshmëri me konstatimin e organit mbikëqyrës dhe me nenin 16.1. të Kontratës, PJESA E KONTRATES III - KUSHTET E VEÇANTA e ka penalizuar dhe ia ka ndalur për 10 % më pak të vlerës së kontratës (226,865.48 € x 10 % =22,686.55 €) me rastin e pagesës së Situacionit të dytë.</li> </ul> <p>Shuma e faturës 07-220-001-4 26,440.35 €</p> <p><u>Shuma e garancionit e cila është zbritur</u> <u>..... 22.686.55 €</u></p> <p>Janë paguar vetëm 3,753.80 €</p>	<p><b>Rekomandimi nr. 5.2</b></p> <p>Pranohet komenti i MPB-së sa i përket Ndërtimit të QRA dhe QKRC në Kamenicë.</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Punimi i rrethojës, shkallëve dhe murit mbrojtës në QRA Pejë, këtu kemi të bëjmë me fillimin e punimeve në fundin e vitit dhe</li> </ul>	<p>Mbetet e gjetura dhe rekomandimi në raport.</p> <p>MPB –ja duhet të ketë parasysh që punët</p>

<p>kemi pas të bëjmë me punët ndërtimore të lidhura shumë me kushte atmosferike, dmth ka qenë punë përjashta objektit dhe sipas mbikëqyrjes të emëruar nga MPB, nuk ka pasur ngecje në punime por kushtet atmosferike nuk kanë lejuar përfundimin e punimeve kështu që Autoriteti Kontraktues (MPB) ia ka paguar vetëm punët e kryera të cilat kanë qenë 90%.</p>	<p>ndërtimore jashtë objekteve ti planifikoj dhe të kryen në kohë të përshtatshme-sezonale. Gjatë kohës sa ka qenë ekipi i ZAP në auditim menaxheri i prokurimit ka pranuar se ende punët nuk janë kryer.</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në kontratën Renovimi i SHPK- për QRA-QKRC në Skënderaj. Këtu gjatë kryerjes së punimeve nga Menaxheri i projektit nga MSHP-DSHIMN ka konstatuar se ka nevojë për punë shtesë të cilat nuk kanë mundur me u parapa me kohë, në vlerë prej 3,306.50 € ose 7,49 % nga vlera e punës së kontraktuar prej 44,106.59 €, për shkak të sezonit dimëror kur janë realizuar punimet, për shkak të procedurave dhe kërkesës për miratim në Agjencionin e Prokurimit është prolonguar dhe vonuar realizimi i këtij projekti, kurse informacione se është vonuar operatori ekonomik në planin dinamik nuk kemi pasur.</li> </ul>	<p>Mbetet e gjetura dhe rekomandimi i ZAP-it.</p> <p>E gjetur jonë ka të bëjë me kontratën bazë, e jo me Aneks kontratën.</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i objektit të QKRC dhe QRA në Shtime. Edhe këtu gjatë kryerjes së punimeve nga Menaxheri i projektit nga kompania mbikëqyrëse e zgjedhur nga MPB janë konstatuar se ka nevojë për punë shtesë të cilat nuk kanë mundur me u parapa me kohë, në vlerë prej 22,676.00 € ose 8,93 % nga vlera e punës së kontraktuar prej 253,859.04 €, për shkak të sezonit dimëror kur janë realizuar punimet, për shkak të procedurave dhe kërkesës për miratim në Agjencionin e Prokurimit është prolonguar dhe vonuar realizimi i këtij projekti, kurse informacioni se është vonuar operatori ekonomik në planin dinamik nuk kemi pasur. Sa i përket gjeneratorit dhe gilinderave nuk janë paraparë në paramasë dhe parallogaritë e projektit të përgatitur nga MSHP-DSHIMN-ja. (shih paramasën dhe parallogarite e këtij tenderi).</li> </ul>	<p>E gjetura e rekomandimi mbetet në raport.</p> <p>ZAP-it nuk i është ofruar dëshmi për vonesat gjatë kryerjes së punimeve nga ana e organit mbikëqyrës.</p> <p>E gjetura ka të bëjë me Kaldajën, referoju paramasës: Ngrohja qendrore, Kaldatorja paragrafi I.</p>

<p><b>Komenti nr. 5.3</b></p> <p>Afati i garancionit të disa kontratave në ndërtimtari nuk e ka mbuluar tërë periudhën e garantuar 12 mujore por kjo ka ndodhur për shkak të vonimit në realizimin e punimeve për shkak të paraqitjes së punëve shtesë, kjo në të ardhmen do të kërkohej të vazhdohej afati i vlefshmërisë së Garancionit të ekzekutimit.</p>	<p><b>Rekomandimi nr. 5.3</b></p> <p>MPB e pranon të gjeturën dhe konkluzionin e ZAP.</p>
<p><b>Komenti nr. 5.4</b></p> <p>Te kontrata për furnizim me pasaporta në shumë prej 1,825,426 €, pagesa është bërë nga kodi ekonomik 31900 pasi që edhe nga vetë MEF nuk është lejuar që këto furnizime të planifikohen në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime me arsyetimin se po rritet përqindja e kësaj kategorie. Mirëpo kjo do të ndodhë edhe në vitin 2009 ndërsa për vitin 2010 kemi arritur që kjo pjesë e mjeteve të kalojë në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime.</p>	<p><b>Rekomandimi nr. 5.4</b></p> <p>Mbetet e gjetura dhe rekomandimi në raport.</p> <p>Ne kemi konstatuar se nuk është bërë shpalosja në shënimet shpjeguese.</p>
<p><b>Komenti nr. 5.5</b></p> <p>Në lëndën me nr të prokurimit 214208/08/094/136 MPB-ja e ka shpërblyer OE i cili ka qenë i papërgjegjshëm. Këtu kemi të bëjmë me një gabim teknik sepse kërkesat të cilat duhet me i plotësuar një Operator Ekonomik-ofertë.</p>	<p><b>Rekomandimi nr. 5.5</b></p> <p>Mbetet e gjetura dhe konkluzioni i ZAP-it në raport.</p> <p>.</p>
<p><b>Avanset për udhëtime zyrtare</b></p>	
<p><b>Komenti nr. 6</b></p> <p>Të gjitha udhëtimet zyrtare llogariten në bazë të tarifave të cilat janë të përcaktuara me udhëzimin administrativ 2004/07 MSHP. Gjithashtu për çdo udhëtim zyrtar paraprakisht përgatitet shkresa e cila aprovohet nga ministri gjë të cilën e përcakton vendimi i Qeverisë dhe po ashtu për secilin zyrtar plotësohet formulari për mëditje i cili po ashtu është pjesë e udhëzimit 2004/07.</p> <p>Ne do të mundohemi që në të ardhmen ti përmbahemi afatit kohor për mbylljen e avanseve të përcaktuar me udhëzim.</p>	<p><b>Rekomandimi nr. 6</b></p> <p>Mbetet e gjetura dhe rekomandimi i ZAP-it.</p> <p>Komenti i MPB-së nuk qëndron sa i përket plotësimit të formularit për udhëtime zyrtare dhe llogaritjen e mëditjeve.</p>



<b>Paraja e imët</b>	
<b>Komenti nr. 7</b> Ne punojmë duke u bazuar në rregulloren, Udhëzimet e Thesarit 02 -për mënyrën e shpenzimit të parasë publike në të gatshme, mirëpo në të ardhmen do të mundohemi që ky udhëzim të respektohet me përpikëri edhe më të madhe.	<b>Rekomandimi nr. 7</b> MPB- ja pajtohet me të gjeturën dhe konkluzionin e ZAP-it..
<b>Menaxhimi I Pasurive</b>	
<b>Komenti nr. 8</b> MPB-ja është duke punuar me hap shumë të shpejtë në regjistrimin e pasurisë së MPB-së të cilat kanë mbetur të pa evidentuara në program nga të gjitha kategoritë ekonomike duke përfshirë edhe ndërtimet e objekteve, renovimet etj, si dhe vendosjen e barkodeve në gjithë inventarin e MPB-së.	<b>Rekomandimi nr. 8</b> Mbetet e gjetura dhe rekomandimi i ZAP-it Inkurajojmë punën të cilën është duke e bërë zyrtari i pasurisë për implementimin e rekomandimit, nëse ka elemente të rekomandimit që MPB i ka realizuar, tashmë kjo do të thjeshtësoj zbatimin e plotë të këtij rekomandimi.
<b>Auditimi i brendshëm</b>	
<b>Komenti nr. 9</b> Në kuadër të Pikës 9- Sistemi i kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm, faqe 20 në vlerësimin e ZAP-it thuhet, Citat: "Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përgatitur 5 raporte për vitin 2008, dy prej tyre me kërkesë të menaxhmentit" Komenti i NJAB-it: Konstatimi i lartë cekur nuk qëndron - si duket është një përvjedhje teknike e gabimit të ekipit të auditimit të ZAP-it sepse, NJAB-i gjatë vitit 2008 ka përgatitur këto raporte auditimi: <b>a)</b> Janë 5 raporte të auditimeve të rregullta - sipas planit vjetor. Raporti i auditimit: " Rishikimi i procedurave të prokurimit" Raporti i auditimit: " Rishikimi i procedurave të parave të gatshme" Raporti i auditimit: "Avanset për udhëtime zyrtare dhe Mëditjet për të punësuarit" Raporti i auditimit: "Menaxhimi i automjeteve zyrtare"dhe Raporti i auditimit: "Menaxhimi i Depove". <b>b)</b> Janë 3 raporte të auditimeve me kërkesë të menaxhmentit: Raporti i auditimit: "Furnizimi me rafta	<b>Rekomandimi nr. 9</b> Mbetet e gjetura dhe rekomandimi i ZAP-it. <b>a)</b> Po ia përkujtojmë NJAB-së se ZAP ka kryer auditimin e PF për vitin fiskal 2008, kurse raportet “Rishikimi i procedurave të parave të gatshme” dhe raporti “Avanset për udhëtime zyrtare dhe mëditjet për të punësuarit” i përkasin <b>vitit fiskal 2007</b> , kurse Raporti i auditimit “ Menaxhimi i Depos” është i <b>vitit fiskal 2005</b> . <b>b).</b> Po ashtu edhe Raporti i auditimit “Renovimi i objektit të Kosovares”i takon <b>vitit fiskal 2006</b> . <b>c)</b> Ne kemi vlerësuar raportet të cilët janë kryer nga NJAB për periudhën e vitit 2008.

<p>metalik "</p> <p>Raporti i auditimit: "Renovimi i objektit të Kosovares " dhe</p> <p>Raporti i auditimit: "Furnizimi me uniforma-robe mbrojtëse për zjarrfikës".</p> <p>c) Janë 2 pilot raporte të auditimeve si pjesë e trajnimeve të AER-it</p> <p>Pilot raporti i auditimit në Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe</p> <p>Pilot raporti i auditimit në Ministrinë e Mirëqenies Sociale</p>	
<p><b>Komenti nr. 9.1</b></p> <p>NJAB-i gjatë vitit 2008, ka kryer dy auditime financiare në Divizionin për Buxhet dhe Financa duke përfshirë avanset dhe paratë e gatshme, arsyeja e mospërfshirjes më të gjerë të të hyrave dhe pasurisë së MPB-së ka qenë mos bërja e dyfishtë e punës ,pasi që ZAP-i paraprakisht kishte zhvilluar auditimin e pasqyrave financiare gjegjësisht të të hyrave dhe pasurisë.</p> <p><b>Komenti nr .9 2</b></p> <p>Sa i përket pavarësisë së veprimit të auditorit të brendshëm, konsiderojmë se ajo deri më tani është respektuar në vazhdimësi.</p>	<p><b>Rekomandimi nr. 9.1</b></p> <p>Mbetet e gjetura dhe rekomandimi i ZAP-it.</p> <p>Raportet e cekura nuk i takojnë vitit fiskal 2008</p> <p><b>Rekomandimi nr. 9.2</b></p> <p>Ne kemi kënaqësinë të raportojmë informimin sa i përket pavarësisë së veprimit të auditorit të brendshëm në MPB.</p>